



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 833/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zydi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Kasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Mentor Jashari, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj nga subjekti politik Iniciativa Qytetare, me seli në Prishtinë, dega në Skënderaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas shpalljes e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Mentor Jashari, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj nga subjekti politik Iniciativa Qytetare, me seli në Prishtinë, dega në Skënderaj, me shenjën ZL.Anr.833/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, Mentor Jashari, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj nga subjekti politik Iniciativa Qytetare, me seli në Prishtinë, dega në Skënderaj me të cilën pretendohet se me rastin e garës zgjedhore nga radhët e subjektit politik Iniciativa Qytetare për anëtar të Kuvendit Komunal në Skënderaj ka marrë 256 vota dhe ka qenë më i votuari, ndërsa pas certifikimit të rezultateve zgjedhore subjekti politik Iniciativa Qytetare ka fituar 908 vota, pasi që ka pasur 256 vota, duke shtuar se ka ardhur në shprehje kandidatja që ka pasur 64 vota, prandaj PZAP-it i ka kërkuar që ti njihet e drejta për anëtar të Kuvendit Komunal në Skënderaj.

PZAP-i, pas shqyrtimit të të apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur dëshmi lidhur me pretendimet e parashtruar në apel dhe sepse nuk është identifikuar asjë Qender e Votimit, ku janë bërë shkeljet. Prandaj apelin e konsideroj si të përgjithësuar dhe te pa argumentuar me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozita ligjore nga neni 117 i Ligjit nr. 03/-073 për zgjedhjet e përgjithshme.

Rrjedhimisht PZAP- në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bidese për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjale është i pa bazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tilla apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)

Anr.833/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Gylfene Sylejmani

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*